



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2020:002047  
Datë: 11.04.2024  
Numri i dokumentit: 05562329

C.nr.53/20

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike të paditëses S.D.B. nga Ferizaj, rr. ..., nr. ..., kundër të paditurve B.A. nga fshati ...-Komuna Gjilan, K.D. nga fshati ....-Komuna Gjilan dhe E.M. nga fshati ....-Komuna Viti, me objekt kontesti kompensim dëmi, vlera e kontestit 3,000€, jashtë seance me datën 11.04.2024, ka marrë këtë:

**A K T V E N D I M**

Konsiderohet e tërhequr padia e paditëses S.D.B. nga Ferizaj, kundër të paditurve B.A. nga fshati ...-Komuna Gjilan, K.D. nga fshati ....-Komuna Gjilan dhe E.M. nga fshati ....-Komuna Viti, me objekt kontesti kompensim dëmi, vlera e kontestit 3,000€.

**A r s y e t i m i**

Paditësja S.D.B. nga Ferizaj, me datë 09.01.2020 ka ushtruar padi në këtë gjykatë, kundër të paditurve B.A. nga fshati ...-Komuna Gjilan, K.D. nga fshati ....-Komuna Gjilan dhe E.M. nga fshati ....-Komuna Viti, me objekt kontesti kompensim dëmi, vlera e kontestit 3,000€.

Gjykata me qëllim të procedimit të kësaj çështje me datën 14.03.2024 ka nxjerrë Aktvendim për korrigjim të adresave të paditurve B.A. nga fshati ...-Komuna Gjilan, K.D. nga fshati ....-Komuna Gjilan dhe E.M. nga fshati ....-Komuna Viti sepse në procedurën e përgatitjes së shqyrtimit kryesor ia ka dorëzuar padinë të paditurve për të dhënë përgjigje në padi por rezulton që pas tentimeve të bëra dorëzimi personal të paditurve nuk i është bërë asnjëherë kryesisht për shkak të adresës së të paditurve.

Nga fletëkthesa shihet se me datën 19.03.2024, paditësja personalisht ka refuzuar pranimin e aktvendimit të dt. 14.03.2024 për korrigjim të adresave të paditurve.

Sipas nenit 121.3 të LPK parashihet se: “Po që se marrësi refuzon ta firmosë dëftesën e komunikimit, komunikuesi do ta konstatojë një gjë të tillë në dëftesën e komunikimit dhe do ta shkruajë me shkronja datën e dorëzimit dhe kështu konsiderohet se është kryer dorëzimi i rregullt.”

Andaj, edhe për kundër faktit se paditësja, është njoftuar me rregull sa i përket parregullsisë së padisë si dhe të njëjtës i është dhënë mundësia e plotësimit të saj, me çka deri në marrjen e këtij aktvendimi gjykata nuk ka pranuar parashtrësë për rregullimin e padisë respektivisht plotësimin e padisë me adresat e saktë të palëve të paditura, edhe pse me pikën II. të dispozitivit të aktvendimit të datës 14.03.2024 të kësaj gjykate është njoftuar paditësja për pasojat ligjore përkatësisht se do të konsiderohet se është tërhequr padia po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit ligjor, e në qoftë se kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, do të hedhet poshtë padia.

Andaj gjykata mbi këtë bazë konform nenit 102, par. 3 të LPK lidhur me nenin 387, pika s) të LPK, nenin 99.2 të LPK dhe nenin 253.1 pika f) të LPK, padinë e paditëses e ka konsideruar si të tërhequr, pasi që padia nuk është plotësuar në afatin e paraparë ligjor.

Nga se u tha më lartë, e konform nenit 142 të LPK u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.53/20, datë 11.04.2024

Gjyqtari,  
Armend Ahmeti

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate.